

AKT THEMELIMI

i Shoqërisë me Pergjegjesi te Kufizuar
“**USAlb & Co**” sh.p.k

Sot, me datë 15.03.2022 , une i poshtëshënuari:

Bardhi Meli, i biri i Dervish-it, i datëlindjes 01.09.1965, lindur në Fier e banues në Fier, mbajtës i leternjoftimit ID nr 034049315, person madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar

kam vendosur që, në bazë të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” dhe Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”:

të themeloje një Shoqëri me Pergjegjesi te Kufizua të emëruar “**USAlb & Co**” shpk (më poshtë referuar si “Shoqëria”), duke nënshkruar këtë Akt Themelimi. Aktiviteti i saj do të rregullohet nga Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij Akti Themelimi.

NENI 1

Krijimi, Emërtimi

Shoqëria është person juridik i të drejtës shqiptare: Shoqëri me Pergjegjesi te Kufizuar me ofertë private (më poshtë e quajtur “Shoqëria”).

Emërtimi i shoqërisë është “**USAlb & Co**” shpk.

NENI 2

Kohëzgjatja e Veprimtarisë

Afati kohor i zhvillimit të aktivitetit është i pakufizuar dhe fillon me regjistrimin e shoqërisë në Registrin Tregtar.


Shoqëria “**USAlb & Co**” shpk e fiton personalitetin e saj juridik nga dita e regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjitsrit.

Ortaku/Ortaket e Shoqërisë mund të vendosin kufizimin e afatit të veprimtarisë dhe me pas zgjatjen e tij një apo disa herë, sipas një vendimi të posaçëm.

NENI 3

Objekti i Veprimtarisë

1- Projekte dhe konsulencë në:



- a- fushën e gjeologjisë së kërkimit të naftës, gazit dhe ujit.
- b- përgjithësime gjeologjike komplekse (të materialeve sejzmike, të rilevimit, gjeokimike, kimiko-mineralogjike etj), projektim pusesh kërkimi dhe zbulimi në rajone konkrete me prespektivë për naftë dhe gaz dhe uje.
- c- Interpertime të karrotazheve të thellësisë për naftë-gas-ujë, mbajtjen e shtresave si dhe për gjëndjen teknike të kollonave dhe çimentos,
- d- fushën e teknologjisë së shpimit të puseve të thellë e shumë të thellë deri në 7000 m, në prerje terigjene me presione anormale të larta dhe në prerje flishore e karbonatike me konfiguracion të drejtë e deri në konfiguracion horizontal të trungut,
- e- përvetësimin e shtresave produktive naftë-gaz mbajtëse,
- f- shfrytëzimin dhe përpunimin e rezervave të zbuluara të naftës dhe gazit,
- g- likujdimin e avarive dhe kapërcimin e komplikacioneve në fushën e teknologjisë së shpimit, nxjerrjes,
- h- llogaritje komplekse hidraulike në procesin e shpimit dhe nxjerrjes së naftës dhe gazit,
- i- llogaritje rezervash të naftës, gazit dhe ujit me metoda komplekse,
- j- i sigurimit nga zjarri dhe i shuarjes së zjarreve eventuale të objekteve të industrisë së naftës dhe gazit.
- k- transportin, kondicionimin dhe rezervimin e naftës dhe gazit e të nënprodukteve të tyre.
- l- trajtim mjedor të aktivitetit të shpimit të puseve të thellë e shumë të thellë, përvetësimit dhe nxjerrjes, transportit të naftës dhe të gazit.
- m- hartimi i preventivave për kryerjen e proceseve të studimit, projektimit dhe zbatimit në fushën e gjeologjisë, shpimit, nxjerrjes, grumbullimit, kondicionimit dhe transportit të naftës dhe gazit.
- n- Studim i tregut dhe konjunkturave në fushën e industrisë së naftës dhe gazit

2- Sherbime per:

- a- Kryerje procesesh nentokesore ne puset e naftes, sherbime te remonteve nentokesore ne puset e nxjerrjes se naftes dhe gazit,
- b- Kryerje e punimeve intensifikuese dhe remontuese ne puset e nxjerrjes se naftes, gazit dhe ujit,
- c- Transport me bote te lengjeve larese gjate shpimit dhe remonteve ne destinacione te ndryshme,
- d- Perpunimin dhe transportin per ne landfile te shllamrave qe dalin gjate procesit te shpimit dhe mbetejeve te tjera te procesit te shpim dhe pervesim,
- e- Furnizimin me bazë materiale-teknike për shpimin dhe nxjerrjen e naftes dhe gazit,
- f- Tregimi dhe grumbullimi i skrapit,
- g- përcaktim moshere makro- mikrofaunistike dhe sporopolene,
- h- përcaktim të parametrave fiziko-kimik të lëngjeve larëse dhe të solucioneve dhe gurit të çimentos,
- i- analiza komplete nafte, gazi dhe uji,
- j- analiza komplekse të bashkëveprimit të lëngjeve larëse me formacionet që shpohen,
- k- mbylljen e fontanave të hapura e të pa kontrolluara të naftës gazit dhe ujit,
- l- Njohjen e legjislacionit që ka të bëjë me industrinë e naftes dhe gazit,

- m- Sigurimi i fuqisë punëtore dhe të kualifikuar që kërkohen nga kompani që operojnë në industrinë e naftës (të huaja apo të vëndit) për kryerjen e operacioneve në industrinë e naftës dhe gazit,
- n- Ekspertizë dhe auditim tekniko shkencorë dhe ligjorë në fushën e naftës dhe gazit,
- o- Përpilim i softeve kompjuterike për qëllime të ndryshme në kuadrin e industrisë së naftës dhe të gazit.

3- Supervizim të:

- a- proçeseve të ndryshme teknologjike të shpimit dhe nxjerrjes, çimentimit, lëngje larëse, përvetësimit, uljes së kolonave të rrethimit, etj.
- b- ndërtimit të tubacioneve të transportit të naftës dhe gazit,
- c- ndërtimit të rezervuarëve të naftës dhe nënproukteve të saj, të çdo kapaciteti.

4- Prodhim i :

- a- materialeve të nevojshme për industrinë e naftës dhe gazit.

5- Eksport-Import i :

- a- Import-eksport i produkteve industriale,
- b- Tregtimi me shumice dhe pakice i materialeve inerte, lendeve djegese,
- c- Tregetim pjese kembimi dhe aksesore per automjete, mjete te renda me rrata e te dhembzuara qe perdoren per levizje dheu, ngritje e punime speciale, anije, mjete transportuese e ngarkuesse qe perdoren ne porte detare hidrovore dhe stacione pompimi, makineri e pajisje qe perdoren ne miniera e ne nxjerrjen e naftes,
- d- Tregtim me shumice dhe pakice i materialeve hidraulike, materialeve elektrike e elektronike, pajisjeve mekanike dhe makinerive te ndertimit, produkteve te agrikultures,
- e- Tregtim me shumice i materialeve te industrije se naftes dhe gazit,
- f- Tregtim artikuj te ndryshem industriale si instrumenta e vegla pune, kushineta, elektroda, artikuj prej celiku, gize, bakri, alumini, si tubo, llamarina, profile perçjeljesa, artikuj prej kaucuku dhe PVC, artikuj te gomuar si goma rripa, permistop, kimikate, karbit, bentonit, rere kuarcore, solucione antikorozive,
- g- Shitje dhe sherbim pompa per naftë; Shitje dhe sherbim pjese kembimi per pompa nafte

6- Aktivitet ne ndertim :

- a- Aktivite ndertimi si dhe investimi ne ndertim,
- b- Punime ndertimi te cfaredolloj dhe rikonstruksione,

NENI 4

Selia, Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit

Selia e Shoqërise do të jetë në: Qytetin Patos, Lagja: "1 Maj", Rruga: "Unaza e Re"; (Postcode 9307); Zona Kadastrale 2890, Nr i Pasurise 21/24, Vol 14, Fq 85;

Personat përgjegjës për administrimin e shoqërisë mund të vendosin hapjen e degëve dhe/ose të zyrave të përfaqësimit të shoqërisë.

NENI 5

KAPITALI, NDRYSHIMET E KAPITALIT

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është kontribut në para 100.000 (njeqindemije) lekë i cili i perket një kuote te vetme. Kapitali i Shoqërise tregtare " USA Alb & Co " shpk zotërohet 100% nga ortaku i vetëm i shoqërisë.

- Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet ose zvoglohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme se Ortakeve.
- Kapitali i shoqërisë mund të rritet nëpërmjet kontributit në natyrë apo në të holla siç parashikohet në ligj.
- Kuotat e kapitalit e shoqërisë dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo të kalohen nëpërmjet:
 - a) kontributit në kapitalin e shoqërise, në çastin e formimit të shoqërisë,
 - b) shitblerjes,
 - c) trashëgimisë,
 - d) dhurimit,
 - e) çdo mënyre tjetër të parashikuar në ligj.

NENI 6

Organet e Shoqërisë

Organet e Shoqërise

Organet e shoqërisë janë:

- 1) Asambleja e Përgjithshme
- 2) Administratorët.

Përbërja, kompetencat dhe rregullorja e funksionimit të tyre përcaktohen në Statut.

NENI 7

Prishja dhe likuidimi

Prishja, likuidimi

Shoqëria me perjegjesi te kufizuar prishet :

Kur mbaron kohëzgjatja për të cilën është themeluar;

Kur merr vendim Asambleja e Përgjithshme;

Me hapjen e procedurave të falimentimit;

Kur nuk ka kryer veprimitari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimitarisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit;

Me vendim gjykate.



Shoqeria likuidohet në dy mënyra, likuidimi i zakonshem dhe likuidimi i thjeshtëzuar.

Likuidimi i zakonshëm kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Asambleja e Përgjithshme. Në rast se Asambleja nuk merr vendim per caktimin e likuiduesit ai zgjidhet nga gjykata.

Likuidimi i thjeshtëzuar mund të kryhet nëpërmjet një procedure të përshpejtuar, nëse kjo vendoset nga ortaku dhe kur ai deklaron përpara Gjykatës përkatese se të gjitha detyrimet e shoqërise ndaj kreditoreve janë shlyer e janë rregulluar të gjitha marrëdhëni me punëmarrësit.

Administratorët njoftojnë pranë Qëndrës Kombëtare të Regjistrimit vendimin për likuidimin e shoqërisë, nëpërmjet procedurës së thjeshtëzuar, gjithashtu ata janë përgjegjes për dëmin e shkaktuar nga shkelja e detyrave të tyre gjatë likuidimit.

NENI 8

Dispozita përfundimtare

Ky Akt Themelimi u redaktua në tre kopje me përbajtje dhe vlerë të njëjtë juridike në gjuhën shqipe. Pasi miratohet në parim dhe nen për nen nga Ortaku themelues i shoqërisë, ai nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendsur emrin, mbiemrin dhe firmën origjinale të Ortakut te Vetem Themelues.

ORTAKU I VETEM THEMELUES

1. Z.Bardhi MELI

